



PSH .nr. 395/20
404/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Goran Milenković - Kryetar z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE “Arhiko.ing O.P”-Prishtinë si dhe ankesës së OE “TAULANT SHPK & STUDIO HAPSIRA SHPK”-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: “Infratek”NTSH, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i Projekteve” me nr. të prok: VU644-20-713-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Vushtrri, më datën: 27.07.2020, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Arhiko.ing O.P” Prishtinë, dhe ankesa e OE “TAULANT SHPK & STUDIO HAPSIRA SHPK”-Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i Projekteve” me nr. të prok: VU644-20-713-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Vushtrri.

II.ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i Projekteve” me nr. të prok: VU644-20-713-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Vushtrri dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “TAULANT SHPK & STUDIO HAPSIRA SHPK”-Prishtinë, dhe ankesa e OE “Arhiko.ing O.P”-Prishtinë, aprovohen pjesërisht si te bazuara te dy operatoreve ekonomik ankues ju bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE “Arhiko.ing O.P”-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 19.06.2020 me nr. 395/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i Projekteve” me nr. të prok: VU644-20-713-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Vushtrri, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7, 13, 59, 65, 66, 69 dhe nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe neni 10 i Ligjit të Punës 03/L-212.

Operatori ekonomik ankues OE “TAULANT SHPK & STUDIO HAPSIRA SHPK”-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 22.06.2020 me nr. 404/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i Projekteve” me nr. të prok: VU644-20-713-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Vushtrri, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7, 51, 56 dhe nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe neni 39 dhe 39.8 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 25.06.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtuese e prokurimit në raportin e dt: 06.07.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

OE ankuesi “Arhiko.ing”O.P, është eliminuar me arsyetimin se nuk i përmbushë Kërkesat sikurse janë

kërkuar tek FDT, Kërkesat mbi mundësitë Teknike dhe / ose profesionale, neni 9.1 lidhur 9.2 pika 1. Ku ky i fundit nuk ka dorëzuar Listën e shërbimeve të përfunduara në tre vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë si dhe referencave të dorëzuara për të dëshmuar vlerën e shërbimeve të përfunduara në tre vitet e fundit.

Eksperti Shqyrtues pretendimin e gjen të pa bazuar pas verifikimit të Listës së Projekteve dhe konform dispozitave ligjore, periudha e vlefshmërisë e kontratave si referencë merret duke pasur parasysh datën e përfundimit të kontratës. Një gjë e tillë mund të shihet edhe në RRUOPP, tek pjesa e “Shënim për kërkesat e aftësisë teknike dhe/ose profesionale (neni 69 i LPP-se):”, gjegjësisht pjesa: “Në të gjitha rastet e përfshira në 2.1, 4.2 dhe 6.2 të nenit 69 të LPP-se përmendet shprehja si në vijim citojmë: “.....të realizuara (përfunduara) në tri vitet e shkuara “ose “...në periudhën e shkuar trevjeçare...”). Në kuptimin e Ligjit shprehja “tri vitet e shkuara” nënkupton: Periudhën kohore të përcaktuar në këto nene e cila ndërlidhet me periudhën që paraprin datën e publikimit të njoftimit për kontratë ose, në rast të procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës, dërgimin e ftesës për pjesëmarrje ose tenderim”

Shih faktin 1&2 tek faktet e rëndësishme:

Fakti 1: Kërkesat dhe mundësitë teknike dhe / ose profesionale 9.1& 9.2

Citat” Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për shërbime të ngjashme me natyrën e aktivitetit, në vlerë minimale prej 400,000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë. Nëse OE tenderojnë si grup i operatoreve ekonomik apo konsorcium, atëherë lideri i grupit duhet t'i ketë 60% të vlerës së kërkuar.”

Fakti 2: Lista e projekteve- ku me mbledhjen në total të projekteve të realizuara brenda periudhës tri vjeçare janë nën vlerën 400.000,00€≥339.499,16€.

Ndërsa sa i përket shkeljeve/pretendimeve të tjera:

Shkelja e parë: OE i rekomanduarit Deklaratën nën betim e ka të nën shkruar nga personi i autorizuar i cili nuk është person përgjegjës për biznesin dhe se nuk figuron në ARBK si drejtor përgjegjës.

Eksperti Shqyrtues pas verifikimit të ofertës së rekomanduarit, pretendimin e gjen të pa bazuar, për faktin se në ofertë është e bashkangjitur Autorizimi nga OE, Vetëm Jahaj personi përgjegjës për çfarëdo nënshkrimi në këtë aktivitet të prokurimit

Shkelja e dytë: Kontratat e Stafit për periudhë të pacaktuar dhe kontratat për marrëveshje bashkëpunimi nuk janë të hartuara sipas Ligjit të punës 03/212 neni 10 paragrafi 2, pika 2.1 dhe 2.2 dhe neni 1 të shpallur në Gazetën Zyrtare të RKS më datë 01.12.2010 punëdhënësi dhe i punësuar, të gjitha kontratat janë në kundërshtim me ligjin e lartcekur.

Shkelja e tretë: Inxhinieri i Ndërtimtarisë kontrata e nënshkruar nga dy palët më datën 01.06.2009 nuk është konform ligjit të punës të aprovuar më datën 01.12.2010

Gjithashtu edhe Inxhinieri i Hidroteknikës kontrata nuk është e nënshkruar konform Ligjit të punës të aprovuar më 01.12.2010.

Eksperti Shqyrtues pas verifikimi dhe analizimit të pretendimeve dy dhe tre, këto të fundit i gjen të pazuar, për faktin se sa i përket Ligjit të punës 03/212 neni 10 paragrafi 2, pika 2.1 dhe 2.2 thuhet se citat: “2. Kontrata e Punës mund të lidhet për: 2.1. një periudhë të pacaktuar; 2.2. një periudhë të caktuar; dhe 2.3. për punë dhe detyra specifike”, andaj në kontratat e stafit është e cekur afati

1. Vlefshmëria

Kjo kontratë ka vlefshmërinë paraprake dhe me këtë status hynë në fuqi me datë 01.06.2009. Kohëzgjatja është e pakufizuar, dhe do të vazhdojë deri atëherë kur njëra nga palët kontraktuese kërkon ndërprerjen e kësaj Kontrate (shih Pikën 4).

4. Kohëzgjatja e punësimit dhe ndërprerja e kontratës

- 4.1 Kohëzgjatja e punësimit është për periudhë të pacaktuar.
- 4.2 Ndërprerja e kontratës mund të bëhet nga të dy palët me një lajmërim me shkrim në kohë parafajmërimi prej katër javësh.

Ligji i Punës Neni 10, paragrafi 2 dhe 2.1-2.2

Neni 10 Kontrata e Punës

1. Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuar. Kontrata përfshin elementet e përcaktuara sipas nenit 11 të këtij ligji.

2. Kontrata e Punës mund të lidhet për:

- 2.1. një periudhë të pacaktuar;
- 2.2. një periudhë të caktuar; dhe
- 2.3. për punë dhe detyra specifike.

Shkelja e Katërt: Inxhinieri i Gjeodzisë ka ofruar diplomën në gjuhën Kroate gjë që ka br shkelje të LPP-së neni 13-Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e Prokurimit publik.

Ky pretendim i OE ankuesit nuk qëndron i bazuar, për arsye se ne Ofertë të rekomanduar shihet që

Gjeodeti Blerim Jashari ka bashkangjitur edhe Vendimin nga Këshilli Shtetëror për Njohje të Diplomës ku ky dokument është edhe i noterizuar.

Gjersa OE i dytë "Taulant" SHPK & "Studio Hapësira" SHPK:

Anëtari i Grupit të O.E." Taulant "Sh.p.k. Deklaratën nën Betim e ka plotësuar në mënyrë jo të rregullt nga se në preambulë të Deklaratës në Betim referenca është për O.E. " Studio Hapësira "Sh.p.k., ndërsa të dhënat më tej për O.E. " Taulant "Sh.p.k. Kjo e bënë Deklaratën nën Betim fictive, jo të rregullt dhe jo valide, për rrjedhojë dhe të papranueshme për A.K. Në fakt kjo parregullsi paraqet devijim substancial nga Kërkesat Administrative të saktësuara në Dosjen e Tenderit.

Ndërsa arsyetimi i OE ankuesit është se Deklarata në betim i njërit GOE Taulant SHPK është e plotësuar, është konstatuar që identifikimi i OE i vulosur dhe i nënshkruar nga vet Operatori Ekonomik Taulant SHPK, përveç një gabimi tekstual nuk mund të konsiderohet jo valid, duke marrë parasysh që Deklarata në Betim është pjesë e dosjes, dhe dosja është vulosur dhe nënshkruar nga vet OE Taulant SHPK, mbanë identifikimin e vet OE Taulant SHPK dhe i plotësuar dhe vulosur nga ai si lider i Grupit.

Eksperti Shqyrtues pretendimin e OE ankuesit në fjalë e gjen të bazuar, për faktin se gabimin në deklaratën nën betim e konsideron si devijim të vogël teknik për arsye se tek pjesa Identifikimi i OE-së është e plotësuar qartë (Shih faktin lartë Fakti 3- Deklaratë nën betim Aneksi 2.), dhe se meqë ka qenë OE me i lirë nuk është dashur që të eliminohet për këtë devijim.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankuesit "Arhiko.ing" O.P të refuzohet si e pa bazuar ndërsa ankesa e OE ankuesit "Taulant" SHPK & "Studio Hapsira" SHPK të aprovohet si e bazuar dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të anulohet dhe lënda të kthehet ne rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 06.07.2020, me anë të shkresës zyrtare është njoftuar nga OSHP lidhur me mendimin e ekspertit shqyrtues, mirëpo të njëjtit nuk kanë kthyer përgjigje.

Operatori Ekonomik "Arhiko.ing O.P"-Prishtinë, me datë: 07.07.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik "TAULANT SHPK & STUDIO HAPSIRA SHPK"-Prishtinë, me datë: 07.07.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 27.07.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtrësat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesat janë parashtruar kundër Njoftimit për dhëniet kontratës.

Paneli shqyrtues në vijim jep konstatimet lidhur me pretendimet e OE “Arhiko.ing” O.P.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Arhiko.ing” O.P, se AK e ka eliminuar pa të drejtë me arsyetimin se nuk i përmbushë Kërkesat sikurse janë kërkuar tek FDT, Kërkesat mbi mundësitë Teknike dhe / ose profesionale, neni 9.1 lidhur 9.2 pika 1. Ku ky i fundit nuk ka dorëzuar Listën e shërbimeve të përfunduara në tre vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë si dhe referencave të dorëzuara për të dëshmuar vlerën e shërbimeve të përfunduara në tre vitet e fundit.

Paneli shqyrtues duke pas parasysh faktin se OE ankues ka ofruar Listën e Projekteve dhe disa dëshmi përkatës konstatojmë se me rastin e Rivlerësimit AK në pajtim me nenin 59 dhe 72 të LPP-së mund të kërkoj sqarime nga OE ankues në mënyrë që të vërtetoj se OE në fjalë a përmbush kërkesën e AK-së, të cekur si më lart.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se OE i rekomanduari Deklaratën nën betim e ka të nën shkruar nga personi i autorizuar i cili nuk është person përgjegjës për biznesin dhe se nuk figuron në ARBK si drejtor përgjegjës.

Paneli shqyrtues konform Ekspertit Shqyrtues konstaton, se pretendimi është i pa bazuar, për faktin se në ofertën e OE te rekomanduar për dhinë te kontratës është e bashkangjitur Autorizimi nga OE, Veton Jahaj personi përgjegjës për çfarëdo nënshkrimi në këtë aktivitet të prokurimit

Lidhur me pretendimet e ankuesit se Kontratat e Stafit për periudhë të pacaktuar dhe kontratat për marrëveshje bashkëpunimi nuk janë të hartuara sipas Ligjit të punës 03/212 neni 10 paragrafi 2, pika 2.1 dhe 2.2 dhe neni 1 të shpallur në Gazetën Zyrtare të RKS më datë 01.12.2010 punëdhënësi dhe i punësuar, të

gjitha kontratat janë në kundërshtim me ligjin e lartcekur dhe pretendimin tjetër se Inxhinieri i Ndërtimtarisë kontrata e nënshkruar nga dy palët më datën 01.06.2009 nuk është konform ligjit të punës të aprovuar më datën 01.12.2010

Gjithashtu edhe Inxhinieri i Hidroteknikës kontrata nuk është e nënshkruar konform Ligjit të punës të aprovuar më 01.12.2010.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se, sa i përket Ligjit të punës 03/212 neni 10 paragrafi 2, pika 2.1 dhe 2.2 thuhet se citat: “2. Kontrata e Punës mund të lidhet për: 2.1. një periudhë të pacaktuar; 2.2. një periudhë të caktuar; dhe 2.3. për punë dhe detyra specifike”, andaj në kontratat e stafit është e cekura afati si me poshtë:

1. Vlefshmëria

Kjo kontratë ka vlefshmërinë paraprake dhe me këtë status hynë në fuqi me datë 01.06.2009. Kohëzgjatja është e pakufizuar dhe do të vazhdojë deri atëherë kur njëra nga palët kontraktuese kërkon ndërprerjen e kësaj Kontrate (shih Pikën 4).

4. Kohëzgjatja e punësimit dhe ndërprerja e kontratës

4.1 Kohëzgjatja e punësimit është për periudhë të pacaktuar.

4.2 Ndërprerja e kontratës mund të bëhet nga të dy palët me një lajmërim me shkrim në kohë paratijmërimi prej katër javësh.

Ligji i Punës Neni 10, paragrafi 2 dhe 2.1-2.2

Neni 10 Kontrata e Punës

1. Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuar. Kontrata përfshin elementet e përcaktuara sipas nenit 11 të këtij ligji.

2. Kontrata e Punës mund të lidhet për:

2.1. një periudhë të pacaktuar;

2.2. një periudhë të caktuar; dhe

2.3. për punë dhe detyra specifike.

Ndërsa lidhur me pretendimin e ankuesit se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofruar Inxhinierin e Gjeodzisë me diplomë në gjuhën Kroate gjë që ka bërë shkelje të LPP-së neni 13-Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e Prokurimit publik.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se ky pretendim i OE ankuesit nuk qëndron i bazuar, për arsye se në Ofertë të rekomanduar shihet që Gjeodeti Blerim Jashari ka bashkangjitur edhe Vendimin nga Këshilli Shtetëror për Njohje të Diplomës ku ky dokument është edhe i noterizuar.

Paneli shqyrtues në vazhdim jep konstatime lidhur me ankesën e OE “Taulant” SHPK& “Studio Hapësira” Lidhur me arsyen e eliminimit të OE ankues se Anëtar i Grupit të O.E.” Taulant “Sh.p.k. Deklaratën nën Betim e ka plotësuar në mënyrë jo të rregullt nga se në preambulë të Deklaratës në Betim referenca është për

O.E. " Studio Hapësira "Sh.p.k., ndërsa të dhënat më tej për O.E. " Taulant "Sh.p.k. Kjo e bënë Deklaratën nën Betim fictive, jo të rregullt dhe jo valide, për rrjedhojë dhe të papranueshme për A.K. Në fakt kjo parregullsi paraqet devijim substancial nga Kërkesat Administrative të saktësuara në Dosjen e Tenderit.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se gabimin në deklaratën nën betim mund të konsiderohet një devijim i vogël teknik për arsye se kjo deklaratë tek pjesa Identifikimi i OE-së është e plotësuar qartë, këtu kemi parasysh faktin se emri i OE -së i mbetur si gabim teknik rezulton të jete emri i anëtarit të grupit të OE-ve që janë në konzorcium njeri me tjetrin dhe kjo shihet se është veç një gabim teknik që nuk ndryshuar kushtin material të aktivitetit të prokurimit nga se gabimet të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material parashihen edhe në nenin 59.4 të LPP-së.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Komuna Vushtrri

1x1 OE "Arhiko.ing O.P"-Prishtinë dhe

1x1 OE "TAULANT SHPK & STUDIO HAPSIRA SHPK"-Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.